



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr.463 Data 16.06.2011

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 511, DATË 24.10.2002 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PER KOHËZGJATJEN E PUNËS DHE TË
PUSHIMIT NË INSTITUCIONET SHTETËRORE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 19, shkronja "c", 20, shkronjat "ç", "ë" e "g", dhe 29, të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil", të ligjit nr.9131, datë 8.9.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike", dhe të neneve 76-108, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave.

V E N D O S I:

1. Në Vendimin nr.511, datë 24.10.2002, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun I "Kohëzgjatja e punës" bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pika 5 nryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Me kërkesë të eprorit të drejtpërdrejtë dhe me miratimin e titullarit të institucionit qëndror, nga i cili varet institucioni përkatës, nëpunësit apo punonjësit të administratës publike mund t'i

kërkohet të kryejë orë shtesë.

Nëpunësi apo punonjësi i administratës publike, që kryen veprimtari administrative, orët shtesë në punë i kompesohen me pushim, të barabartë me orët shtesë plus 25 për qind të tyre, kur këtp orë janë kryer në ditë të zakonshme pune,apo me orët shtesë plus 50 për qind të tyre, kur orët jane kryer në ditë pushimi, ditë feste apo nga ora 22.00-6.00.

Nëpunësi apo punonjësi i administratës publike, që kryen veprimtari operacionale, orët shtesë në punë, si rregull, i kompesohen me pushim, të barabartë me orët shtesë plus 25 për qind të tyre, kur këto orë janë kryer në ditë të zakonshme pune,apo me orët shtesë plus 50 për qind të tyre, kur orët jane kryer në ditë pushimi, ditë feste apo nga ora 22.00-6.00.

Titullari i institucionit detyrohet t'ia japë kërkuessit këtë pushim, brenda 2(dy) muajve nga kryerja e orëve shtesë.

Në rastet kur është e pamundur dhënia e pushimit për orët shtesë në punë, nëpunësi apo punonjësi i administratës, që kryen veprimtari operacionale, ka të drejtë të kompesohet me shtesë mbi pagën normale. Çdo orë shtesë tej orarit zyrtar, në ditë të zakonshme paguhet mbi pagën orare edhe me 25 për qind shtesë të kësaj page, ndërsa orët shtesë gjatë ditëve të pushimit apo ditëve të festave, si dhe çdo orë shtesë e kryer nga ora 22.00 - 6.00 paguhet mbi pagën orare edhe me 50 për qind

shtesë te kësaj page.

Rregullat për procedurën e kryerjes së pageses së orëve shtesë përcaktohen me udhëzim të ministrit të Financave.”.

b) Pas pikes 5 shtohet pika 6 me kete permbajtje:

“6. NËpunësi apo punonjësi i administratës publike mund të kryejë veprimtari mesimdhënieje pas miratimit nga titullari i institucionit, por jo më shumë se 4 (katër) orë në javë, të cilat kompesohen në orë pune, brenda javes, pas orarit zyrtar të punës. NËpunësi apo punonjësi i administratës publike, që angazhohet në mësimdhënie, detyrohet të depozitojë pranë sektorit të burimeve njerëzore kopjen e kontratës së lidhur me institucionin arsimor.”.

2. Në kreun II “Pushimet” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fund të pikes 2 shtohen dy paragrafë, me këtë përmbajtje:

“Ditët e festave zyrtare nuk duhet të përfshihen në pushimet vjetore të paguara. Nëse nëpunësit të administratës publike dita e festës i bie në periudhën e pushimeve vjetore të paguara, këto të fundit i shtyhen për aq ditë sa ka qenë festa zyrtare.

Rregullat për procedurën e kryerjes së lejes së zakonshme në periudha të ndryshme e të ndara përcaktohen me udhëzim të ministrit të Financave.”.

b) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pushimet vjetore nuk mund të kompesohen me pagesë, përveç rastit kur është zgjidhur marrëdhënia e punës. Çdo marrëveshje, që parashikon heqjen dorë nga e drejta për pushimin vjetor, kundrej pageses, do të jetë e pavlefshme.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

K R Y E M I N I S T E R

SALI BERISHA